



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:184797
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05536872

C.nr.1984/20

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.S. nga Ferizaj, rr. ..., nr. ..., kundër të paditurit S.M., nga Ferizaj, rr. ..., nr. ..., me objekt kontesti vërtetim i pronësisë, vlera e kontestit e pa përcaktuar, pas shqyrtimit të parashtresës së datës 12.03.2024 për tërheqjen e padisë, me datë 03.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet se është tërhequr padia me shenjë C.nr.1984/20 e paditësit A.S. nga Ferizaj, kundër të paditurit S.M. nga Ferizaj, me objekt kontesti vërtetim i pronësisë, vlera e kontestit e pa përcaktuar.

A r s y e t i m

Paditësi A.S. nga Ferizaj, ka ushtruar padi në këtë gjykatë më 24.12.2020 kundër të paditurit S.M. nga Ferizaj, me objekt kontesti vërtetim i pronësisë, vlera e kontestit e pa përcaktuar. Paditësi personalisht me parashtresën e datës 12.03.2024, e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë për arsye se i padituri pas ushtrimit të padisë kundër tij nga ana ime, ka ndërmarrë veprimet e lirimit të pronës sime, duke e hequr rrethojën e ndërtuar nga ai në një pjesë të pronës sime dhe duke e kthyer pronën time në gjendjen e mëparshme, kështu që nuk ekzistojnë më arsyet për ushtrimin e kësaj padie.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261.1 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.1984/20, datë 03.04.2024

Gj y q t a r i
Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.